

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi:

Sami Kurteshi

rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë

ndaj të paditurës:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës

rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

paraqesin:

PADI PËR KONFLIKT ADMINISTRATIV
DHE KËRKESE PËR SHTYRJE TË EKZEKUTIMIT

sipas ligjeve:

Ligji për konfliktet administrative, 03/L-202, nenet 22 dhe 26

Ligji për rregullatorin e energjisë, 05/L-084, neni 49

kundër aktit:

Vendimi V_1204_2019, 27 nëntor 2019

për shkak se:

cenon të drejtat dhe normat kushtetuese, normat ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme dhe ligjet vendore mbi barazinë para ligjit, pronën, ndihmën shtetërore, konkurrencën e lirë dhe mbrojtjen e konsumatorit

Prishtinë, 24 dhjetor 2019

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE.....	3
A. Akti i goditur.....	3
B. Baza juridike e padisë.....	3
C. Legjitimiteti i paditësit.....	3
D. Shkeljet ligjore.....	4
E. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit.....	5
II. PROVA.....	6
III. FAKTET DHE VEPRIMET PROCEDURORE.....	7
A. Palët.....	7
B. Rregullimi energjetik në Evropë.....	7
C. Skemat mbështetëse për energji të ripërtëritshme.....	8
D. Procedura drejt vendimit të goditur.....	9
E. Vendimi i goditur dhe pasojat.....	11
IV. ARSYETIMI JURIDIK.....	12
A. Juridiksioni i Departamentit Administrativ.....	12
B. Padi ndaj aktit përfundimtar.....	12
C. Padi nga pala e autorizuar.....	13
D. Padi brenda afatit.....	13
V. SHKELJET LIGJORE.....	14
A. Të drejtat dhe parimet kushtetuese.....	14
B. Detyrimet ndërkombëtare dhe e drejta materiale.....	17
C. Rregullat dhe parimet e procedurës.....	20
VI. KËRKESË PËR SHTYRJE TË EKZEKUTIMIT.....	24
VII. KËRKESËPADI.....	26

I. PËRMBLEDHJE

A. Akti i goditur

1. Më 27 nëntor 2019, Bordi i së paditurës ka nxjerrë pa paralajmërim një vendim që ngre një skemë mbështetëse me tarifa nxitëse, duke u garantuar disa prodhuesve të paracaktuar të energjisë së ripërtëritshme blerjen me çmim shumë më të lartë se vlera e tregut.¹ Vendimi i së paditurës nuk përmban arsyetim. Tarifat do të jenë në vlerë prej të paktën 16,46 milionë eurosh.² Përfundimisht do të paguhen nga konsumatorët, duke përfshirë paditësin.

B. Baza juridike e padisë

2. Kjo padi ushtrohet sipas nenit 26 të Ligjit për konfliktet administrative³ dhe nenit 49 të Ligjit për rregullatorin e energjisë⁴ ndaj **vendimit V_1204_2019 të së paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji.**

C. Legjitimiteti i paditësit

3. Paditësit Sami Kurteshi është konsumator i energjisë elektrike, të cilit përfundimisht do t'i faturohen tarifat e caktuara me vendimin e së paditurës. Sipas ligjit, një person fizik mund të ushtrojë padi ndaj një akti administrativ që ia cënon të drejtat ose interesat, drejtpërdrejt ose tërthorazi.⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin *Krasniqi kundër RTK-së* gjithashtu njeh të drejtën e qytetarëve për të sfiduar tarifat që u ngarkohen me vendim të shtetit.⁶ Rrjedhimisht, **paditësi ka legjitimitet të plotë aktiv në këtë kontest administrativ.**

1 **Shtojca (1):** Vendimi.

2 **Shtojca (4):** Ndikimi i tarifave nxitëse në çmimin e energjisë elektronike — pagesa shtesë e cila do të paguhet nga konsumatorët.

3 **LKA**, 03/L-202.

4 **LRrE**, 05/L-084.

5 LKA, 03/L-202, nenet 10.1 dhe 21.

6 Rasti KI 11/09, *Krasniqi k. RTK dhe KEK*, GjK, Vendim, 16.10.2009, f. 3–4.

D. Shkeljet ligjore

4. Kushtetuta mbron barazinë para ligjit, pronën, konkurrencën dhe konsumatorin.⁷ Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara detyrojnë Kosovën të zbatojnë legjislacionin e BE-së për energjinë, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.⁸ Normat e BE-së parashohin që përfituesit e ndihmës për energjinë të përzgjedhen me metoda të tregut të lirë (an-kand ose ofertime konkurruese) dhe që ndihma të mënjanohet nga viti 2020.⁹ Sipas ligjeve vendore, e paditura nuk autorizohet të caktojë tarifa nxitëse, por duhet të caktojë tarifa të arsyeshme për energjinë¹⁰ si dhe të mbrojë tregun e lirë dhe konsumatorët.¹¹
5. Ligji detyron të paditurën të arsyetojë vendimet e veta; përndryshe vendimi është i paligjshëm.¹² Sipas rregullave të procedurës, rendi i ditës për mbledhjet e Bordit të njoftohet disa ditë përpara,¹³ kurse organet e administratës të zbatojnë parimet e ligjshmërisë,¹⁴ barazisë e paanshmërisë,¹⁵ profesionalizimit,¹⁶ transparencës,¹⁷ dhe mbrojtjes së interesit publik.¹⁸
6. Rrjedhimisht, e paditura ka nxjerrë vendimin në kundërshtim me të drejtën materiale dhe rregullat e parimet e procedurës:
 - (1) duke caktuar tarifa nxitëse pa bazë ligjore;

7 Kusht., nenet 24, 46 dhe 119.

8 Marrëveshja e stabilizim-asociimit Kosovë-BE (**MSA**), bashkëngjitur ligjit për ratifikim, 05/L-069, nenet 75, 81, 114; Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë (**TKE**), OJ EU L, 198, 20.7.2006, f. 18.

9 **Udhëzimet** rreth ndihmës shtetërore në mbrojtje të mjedisit dhe energji 2014–2020, *EU Guidelines on State Aid for Environmental Protection and Energy 2014–2020*, OJ C 200, 28.6.2014, f. 1–55, para. 108–109.

10 LRrE, 05/L-084, neni 15.1.5.

11 Po aty, neni 15.1.17.

12 LPPA, 05/L-031, neni 48.1; LRrE, 05/L-084, neni 25.9.

13 LRrE, 05/L-084, neni 25.3.

14 Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (**LPPA**), 05/L-031, neni 4, Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (**LASH**), 06/L-113, neni 3.

15 LPPA, 05/L-031, nenet 6 e 7.

16 LASH, 06/L-113, neni 4.

17 LPPA, 05/L-031, neni 9, LASH, 06/L-113, neni 58.

18 LPPA, 05/L-031, neni 4.4; LASH, 06/L-113, neni 4.

- (2) duke paraparë për periudhë 12-vjeçare dhënien e ndihmës shtetërore, që duhet mënjanuar nga viti 2020, dhe duke caktuar vetë tarifa nxitëse për përfituesit tashmë të njohur, në vend se të caktojë tarifat dhe të përzgjedhë përfituesit përmes instrumenteve të tregut;
 - (3) duke caktuar tarifa dukshëm më të larta se çmimi i tregut, duke penguar konkurrencën e lirë, dhe duke dëmtuar konsumatorin që detyrohet të paguajë tarifat; dhe
 - (4) duke mos dhënë arsyetim me shkrim, duke mos kumtuar me kohë rendin e ditës, duke vendosur tinëz, dhe duke favorizuar një listë biznesesh që dihet se kush janë dhe gjasshëm kanë një pronar.
7. Për këto arsye, paditësi i kërkon Gjykatës **të anulojë vendimin e së paditurës.**

E. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit

8. Krahas kësaj padie, paditësi paraqet kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit,¹⁹ sipas nenit 22 të Ligjit për konflikt administrativ. Zbatimi i vendimit do t'i sillte dëm të pariparueshëm paditësit, meqë cakton tarifa në vlerë minimale prej 16,48 milionë eurosh, që do t'u faturohen konsumatorëve e rrymës elektrike.²⁰ Shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, sepse ka mekanizma të tjerë për të nxitur shfrytëzimin me energji të ripëritshme.

19 Shih pjesën VI.

20 Shtojca (4): Ndikimi i tarifave nxitëse [...].

II. PROVA

9. Paditësi mbështet padinë në këto prova, të bashkëngjitura si shtojca dhe të numëruara si vijon:

- (1) Vendimi V_1204_2019 i ZRrE-së, 27.11.2019, 4 faqe
- (2) Vendimi V_810_2016 i ZRrE-së, 19.5.2016, 5 faqe
- (3) Regjistri i aplikuesve për skemën mbështetëse për BRE, ZRrE, 15.5.2019, 21 faqe
- (4) Ndikimi i tarifave nxitëse në çmimin e energjisë elektronike — pagesa shtesë e cila do të paguhet nga konsumatorët, 1 faqe
- (5) Pagesat vjetore për BRE, 2018, 1 faqe
- (6) Raport konsultativ: Përshtatjet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për KOSTT (prill 2019–mars 2020), ZRrE, mars 2019
- (7) Raport konsultativ: Mekanizmi i mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW solare fotovoltaike), ZRrE, 2.5.2019, 9 faqe
- (8) Raport konsultativ: Metodologjia për llogaritjen e tarifave nxitëse për energjinë solare fotovoltaike, ZRrE, 13.10.2014, 12 faqe
- (9) Komenti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë drejtuar ZRrE-së, 15.5.2019, 2 faqe
- (10) Komenti i Zyrës së BE-së në Prishtinë drejtuar ZRrE-së, 1 faqe
- (11) Komenti i Ambasadës së RF të Gjermanisë në Prishtinë drejtuar ZRrE-së, 1 faqe
- (12) Analizë e INDEP për Raportin Konsultativ të ZRRE-së mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike), maj 2019, 7 faqe
- (13) Rendi i ditës për mbledhjen IX të Bordit të ZRrE-së, 14.10.2019, 2 faqe
- (14) Rendi i ditës për mbledhjen X të Bordit të ZRrE-së, 27.11.2019, 2 faqe

III. FAKTET DHE VEPRIMET PROCEDURORE

A. Palët

10. Padiësi Sami Kurteshi, shtetas i Republikës së Kosovës, është konsumator i energjisë elektrike në Kosovë.
11. E paditura, Zyra e Rregullatorit për Energji (**ZRrE**), është organ i paruarur i themeluar me ligj për të rregulluar tregun energjetik.²¹ Ajo është një nga autoritetet përgjegjëse për sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, krahas Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE).²²

B. Rregullimi energjetik në Evropë

12. Tregu i energjisë është treg thelbësisht tejkuftitar, veçanërisht në Evropë. Bashkimi Evropian (**BE**) luan rol kyç në rregullimin e tregut të energjisë në Evropë.
13. Më 25 tetor 2005, Bashkimi Evropian dhe vendet joanëtare të BE-së kanë nënshkruar në Athinë Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë (**TKE**). Kosova, atë kohë e përfaqësuar nga UMMIK-u, ka nënshkruar traktatin dhe e ka ratifikuar atë më 23 dhjetor 2005.
14. Qëllimi i Komunitetit të Energjisë është të krijojë një treg të përbashkët energjetik për Evropën, duke zbatuar legjislacionin e BE-së për energjinë. Krahas energjisë, korniza ligjore e Komunitetit prek mjedisin dhe mbrojtjen e konkurrencës.
15. Për të mbrojtur mjedisin dhe për të ruajtur burimet natyrore, BE ka përkrahur prej kohësh shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (**BRE**). Ato përfshijnë burimet fotovoltaike që shfrytëzohen përmes paneleve diellore, burimet e erës, burimet e ujit dhe biomasën.

21 LRRrE, 05/L-084, nenet 1.1 dhe 4.1.

22 Ligji për energjinë (**LE**), 05/L-081, neni 3.1.31; Rregullore QRK 02/2011, për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar, shtojca 18, ix.

16. Për këtë qëllim, BE ka vendosur caqe detyruese për shtetet anëtare dhe shtetet e Komunitetit të Energjisë.²³ Caku për BRE nënkupton përqindjen e konsumit të energjisë së një shteti që duhet të vijë nga BRE.
17. Republika e Kosovës është zotuar para Komunitetit të Energjisë se do të caktojë caqet në përputhje me direktivat e BE-së. Më 2013, një udhëzim administrativ ka caktuar cakun prej 25 për qind për BRE.²⁴ Pra, 25 për qind e energjisë që konsumohet në Kosovë duhet të përfitohet nga BRE. Më 2016, ky cak është sanksionuar me Ligjin për energjinë.²⁵ Kosova ka mbërritur këtë cak tashmë.

C. Skemat mbështetëse për energji të ripërtëritshme

18. Për të arritur caqet, shtetet dikur kanë përdorur skema mbështetëse. Skema funksionon si lloj subvencionimi përmes tarifave nxitëse (*feed-in tariffs*), që u paguhen prodhuesve të kualifikuar, për periudhë të caktuar dhe sasi të caktuar të energjisë. Skema ka si tavan sasinë apo kapacitetin e energjisë që mund të subvencionohet për burim të caktuar — p.sh., 10 MW për të gjithë prodhuesit e kualifikuar të energjisë fotovoltaike. Secili prodhues i kualifikuar pastaj siguron një hise nga sasia tavan.
19. Në Kosovë, përfituesit e skemës mbështetëse për BRE kanë filluar të regjistrohen qysh më 2013.²⁶ Por ZRrE nuk ka caktuar tarifa nxitëse deri më 2016.²⁷
20. Më 2014, Bashkimi Evropian ka nxjerrë Udhëzimet rreth ndihmës shtetërore në mbrojtje të mjedisit dhe energji 2014–2020. Këto udhëzime kërkojnë përdorimin e ankandëve ose metodave të ngjashme në përzgjedhjen e prodhuesve përfitues nga skemat mbështetëse, në më-

23 Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe për ndryshimin dhe më pas shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE, OJ L 140, 5.6.2009, f. 16–62; Vendimi D/2012/04/MC-EnC i Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

24 UA-MZhE 01/2013, neni 3.1.

25 LE, 05/L-081, neni 15.1.

26 **Shtojca (3):** Regjistri i aplikuesve për skemën mbështetëse për BRE, f. 7.

27 **Shtojca (2):** Vendimi V_810_2016, ZRrE, 19.5.2016.

nyrë që subvencionet të zvogëlohen sa më shumë dhe t'u jepet fund.²⁸ Subvencionet ndalohen nga viti 2020, kur nis liberalizimi i plotë i tregut energjetik për BRE.²⁹

21. Më 2015, Kosova ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (**MSA**) me BE-në dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Bërthamore. MSA-ja parasheh ndalimin e ndihmës shtetërore për veprimtari të caktuara,³⁰ mbrojtjen e konsumatorëve,³¹ si dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë.³²
22. Më 2016, ZRrE ka caktuar lartësinë e tarifave nxitëse në 136,4 euro për MW të prodhuar nga panelet fotovoltaike, të njohura edhe si panele diellore. Kapaciteti tavan për energjinë fotovoltaike është caktuar në 10 MW. Nga tarifat kanë nisur të përfitojnë kompanitë që kishin aplikuar qysh nga 2013-ta, dhe tavani prej 10 MW është mbërritur shpejt.³³ Por kompani të reja kanë vijuar të aplikojnë.
23. Vetëm më 2018, janë paguar rreth 240 mijë euro në emër të tarifave nxitëse për energji fotovoltaike.³⁴

D. Procedura drejt vendimit të goditur

24. Më 2017, MZhE ka nxjerrë një udhëzim administrativ përmes të cilit ka rekomanduar ngritjen vullnetare të caktut për BRE nga 25 për qind në 29 për qind.³⁵ Udhëzimi është miratuar nga ministri në dorëheqje, pasi Kuvendi kishte votuar mosbesimin ndaj qeverisë dhe ish-in shpallur zgjedhjet e reja parlamentare.
25. Vlen të përmendet, se Kosova tashmë kishte mbërritur 25-përqindëshin, si cak të detyrueshëm të vendosur nga Komuniteti i Energjisë. Ndërkohë kanë vazhduar aplikimet e reja në ZRrE për BRE.

28 Udhëzimet 2014–2020, para. 109.

29 Po aty, para. 108.

30 MSA, neni 75.1(c).

31 Neni 81.

32 Neni 114.

33 Shtojca (2): Vendimi V_810_2016, ZRrE, 19.5.2016.

34 **Shtojca (5)**: Pagesat vjetore për BRE, 2018; **shtojca (6)**: Raporti për KOSTT, f. 7.

35 UA-MZhE 05/2017, GZRK 30.6.2017.

26. Më 2019, në emër të caqeve të reja, ZRrE ka paralajmëruar ngritjen e sasisë tavan dhe të tarifave nxitëse për energjinë fotovoltaike. Pas kundërshtimeve publike, ka heshtur çështjen.
27. Një raport konsultativ, që kërkohet me ligj, ka dalë në maj 2019. Raporti ka rekomanduar tarifa nxitëse në lartësi fikse prej 90,5 euro për MW.³⁶
28. Dyshohet se nga raporti konsultativ janë hequr rekomandimet për shfrytëzimin e instrumenteve të tregut, siç janë ofertat konkurruese apo ankandet. Se raportet shpesh janë përpiluar me anshmëri dëshmon ky koment ndërhyrës në raportin e vitit 2014, që me gjasë ka shpëtuar pa u fshirë:
- «**Koment:** Si qendron Shqipëria? Nese çmimi është me i nalt se i Kosoves përshini edhe Shqiperine. Ne Bosnie e Hercegovine çmimi është mjaft i madh andaj ne vend te Greqise mund te përfshini Bosnie dhe Hercegovine [sic]»³⁷
29. Palët e interesuara — duke përfshirë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë,³⁸ Zyra e BE-së në Prishtinë,³⁹ Ambasadën e Republikës Federative të Gjermanisë në Prishtinë,⁴⁰ një organizatë e respektuar hulumtuese,⁴¹ si dhe stafin profesionist të departamentit të tarifave të ZRrE-së⁴² — kanë kundërshtuar vendosjen e tarifave nxitëse pa konkurrencë të lirë. Këto i kanë cilësuar si pengesë për prodhimin e energjisë.
30. Bordi i ZRrE-së ka shqyrtuar çështjen e tarifave nxitëse në mbledhjen IX, të mbajtur më 14 tetor 2019, dhe ka vendosur të mos miratojë tarifave nxitëse në lartësi prej 90,5 eurosh për MW.⁴³

36 **Shtojca (7):** Raporti konsultativ, 2.5.2019.

37 **Shtojca (8):** Raporti konsultativ, 13.10.2014, f. 11.

38 **Shtojca (9):** Komenti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

39 **Shtojca (10):** Komenti i Zyrës së BE-së në Prishtinë.

40 **Shtojca (11):** Komenti i Ambasadës së RF Gjermanisë në Prishtinë.

41 **Shtojca (12):** Analiza e INDEP-it.

42 Videoregjistrimi i mbledhjes IX të Bordit të ZRrE-së, 14.10.2019, *Kallxo.com*, <https://www.facebook.com/kallxo/videos/2692348457476411/>.

43 Po aty; **shtojca (13):** Rendi i ditës i mbledhjes IX të Bordit të ZRrE-së, 14.10.2019.

31. Në nëntor 2019, kryesuesi i Bordit të ZRrE-së ka thirrur mbledhjen X të Bordit për 27 nëntor 2019. Rendi i ditës, siç u është kumtuar anëtarëve të Bordit, nuk ka përfshirë çështjen e skemës mbështetëse apo tarifave nxitëse.⁴⁴
32. Mbledhja ka filluar më 27 nëntor 2019, e shpallur ditë zie kombëtare, pas tërmetit shkatërrues të një dite më parë, me vatër në Durrës. Gjatë mbledhjes, njëri nga anëtarët, z. Izet Rushiti, ka propozuar që Bordi të shqyrtojë rritjen e sasisë tavan dhe vendosjen e tarifave nxitëse për energjinë fotovoltaike. Bordi ka pranuar propozimin.⁴⁵
33. Gjatë shqyrtimit, Bordi nuk ka marrë parasysh komentet ose rekomandimet e palëve të interesuara. Pa një vlerësim paraprak të ekspertëve, gojarisht është propozuar që tarifatat nxitëse të caktohen në lartësi prej 85,5 eurosh për MW.⁴⁶
34. Me gjithë kundërshtimet e fuqishme të disa anëtarëve, Bordi ka nxjerrë vendim mbi çështjen.⁴⁷

E. Vendimi i goditur dhe pasojat

35. Vendimi rrit sasinë tavan të skemës mbështetëse për energjinë fotovoltaike në 20 MW.⁴⁸ Gjithashtu, cakton tarifën nxitëse prej 85,5 eurosh për MW.⁴⁹ Ndërkaq, parasheh që të njoftohen kompanitë që kanë aplikuar për skemën mbështetëse dhe tashmë ndodhen në listë pritjeje. Këto kompani do të përfitojnë sipas radhës kronologjike të aplikimit,⁵⁰ për një sasi maksimale prej 3 MW secila.⁵¹ Kohëzgjatja e mbështetjes do të jetë 12 vjet.⁵²

44 **Shtojca (14):** Rendi i ditës i mbledhjes X të Bordit të ZRrE-së, 27.11.2019.

45 Videoregjistrimi i mbledhjes X të Bordit të ZRrE-së, 27.11.2019, *Kallxo.com*, <https://www.facebook.com/kallxo/videos/581978999013629/>.

46 Po aty.

47 Po aty.

48 Shtojca (1): Vendimi, dispozitivi, pika V.

49 Po aty, pika VI.

50 Po aty, pika III.

51 Po aty, pika VIII.

52 Po aty, pika X.

36. Shumica e ndërmarrjeve në listën e pritjes, që tani do të përfitojnë nga skema mbështetëse, me gjasë kanë të njëjtin pronar, meqë adresa e selisë së tyre është e njëjtë dhe vendndodhja e operimit e përbashkët.
37. Si pasojë e vendimit të ZRrE-së, konsumatorët do t'u paguajnë përfituesve të skemës mbështetëse të paktën 16,46 milionë euro.⁵³ Me rritjen e orëve të diellosjes, rritet kapaciteti prodhues i energjisë fotovoltaike, dhe rrjedhimisht shuma që u faturohet konsumatorëve. Pra, barra mbi konsumatorët pritet të kalojë 20-milionëshin.

IV. ARSYETIMI JURIDIK

A. Juridiksioni i Departamentit Administrativ

38. Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës ka tagër ta shqyrtojë këtë padi dhe të marrë vendim meritore. Ky departament «gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare».⁵⁴
39. Paditësi Sami Kurteshi po parashtrohet padi kundër një akti administrativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji, e cila është organ administrative. Kështu që Departamenti juaj ka tagër mbi këtë lëndë.

B. Padi ndaj aktit përfundimtar

40. Ligji lejon padi ndaj aktit përfundimtar të nxjerrë në procedurë administrative. Rëndom bëhet fjalë për «akti[n] administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë»⁵⁵ ose aktin e shkallës së parë nëse «në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar».⁵⁶ Edhe Ligji për rregullatorin e energjisë parasheh padi ndaj vendimeve të ZRrE-së.⁵⁷
41. Vendimi i ZrE-së është akt i nxjerrë në shkallë të parë, por ndaj të cilit nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Këshilla juridike në

53 Shtojca (4): Ndikimi i tarifave nxitëse [...].

54 LGj, 06/L-054, neni 17.1.

55 LKA, 03/L-202, neni 13.1.

56 Po aty, neni 13.2.

57 LRrE, 05/L-084, neni 49.

fund të vendimit udhëzon palët e pakënaqura të nisin konflikt administrativ në gjykatë. Andaj padia është e lejueshme.

C. Padi nga pala e autorizuar

42. Padinë mund ta ushtrojnë palët në procedurë administrative, por dhe cilado palë e tretë, person fizik a juridik, interesin e së cilës e prek veprimi i goditur — qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi.⁵⁸ Në rastin *Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut*, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka njohur të drejtën e qytetarëve për të sfiduar tarifën të cilat duhet të paguajnë për shkak të një vendimi shtetëror.⁵⁹
43. Në rastin tonë, paditësi është interesi i së cilës dëmtohet me vendimin e së paditurës. Paditësi është konsumator i energjisë elektrike. Tarifën nxitëse, dukshëm mbi çmimin që energjia ka në treg, ndikojnë në shtrenjtimin e energjisë elektrike për konsumatorët.
44. Si pasojë e vendimit të ZRrE-së, konsumatorët — duke përfshirë dhe paditësin — do t'u paguajnë përfituesve të skemës mbështetëse të paktën 16,46 milionë euro.⁶⁰ Me rritjen e orëve të diellosjes, rritet kapaciteti prodhues i energjisë fotovoltaike, dhe rrjedhimisht shuma që u faturon konsumatorëve.
45. Tarifën nxitëse i ka caktuar një organ shtetëror. Sikurse në rastin e RTK-së, edhe në rastin tonë, paditësi duhet të paguajë tarifën që i cakton shteti. Prandaj, paditësi ka legjitimitet aktiv, dhe është palë e autorizuar për të ushtruar këtë padi.

D. Padi brenda afatit

46. Padia duhet të paraqitet brenda 30 ditëve pas dorëzimit të aktit administrativ.⁶¹ Në këtë rast, ZRrE ka marrë vendimin më 27 nëntor 2019, por nuk e ka dorëzuar ose botuar atë deri më 1 dhjetor 2019. Rrjedhimisht, afati i fundit për këtë padi është 31 dhjetori, andaj padia është e afatshme.

58 LKA, 03/L-202, nenet 10.1 dhe 21.

59 KI 11/09, *Krasniqi k. RTK*, Vendim, f. 3, para. fundit.

60 Shtojca (4): Ndikimi i tarifave nxitëse [...].

61 LKA, 03/L-202, neni 27.1; shih dhe LrRE, 05/L-084, neni 49.

V. SHKELJET LIGJORE

47. Pala e dëmtuar mund ta kundërshtojë aktin administrativ, ndër të tjera arsye, nëse organi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, nuk ka ndjekur rregullat e procedurës ose nuk i ka trajtuar drejt faktet.⁶² Për këto arsye, paditësi Kurteshi i kërkon Gjykatës së nderuar ta anulojë vendimin e ZRrE-së për tarifatat nxitëse.

A. Të drejtat dhe parimet kushtetuese

48. Çdo organ shtetëror i nënshtrohet Kushtetutës.⁶³ Agjencitë e pavarura dhe gjykatat ushtrojnë kompetencat e tyre sipas Kushtetutës dhe ligjit.⁶⁴

Sundimi i ligjit, vendimmarrja demokratike, mjetet juridike dhe parime e të drejta të tjera

49. Sundimi i ligjit dhe barazia para ligjit janë ndër vlerat themelore të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me nenin 7 të Kushtetutës.⁶⁵ Institucionet shtetërore kanë detyrë kushtetuese t'i mundësojnë çdonjërit të ndikojë demokratikisht në vendimmarrje.⁶⁶ Kushtetuta gjithashtu parasheh ndalimin e diskriminimit, mbrojtje të barabartë para ligjit, të drejtën e mjeteve juridike, si dhe mbrojtjen e pronës private, konsumatorit dhe konkurrencës së lirë.⁶⁷

Barazia para ligjit

50. Barazia para ligjit mbrohet dhe me instrumente ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme për të drejtat e njeriut, siç janë Deklarata Universale dhe Konventa Evropiane.⁶⁸ Ngjashëm përbëjnë bazë ligjore vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat udhë-

62 LKA, 03/L-202, neni 16.1.

63 Kusht., neni 16.4.

64 Kusht., neni 102.3; LPPA, 05/L-031, neni 4.1; LKA, 03/L-202, neni 4; LASH, 06/L-113, neni 3.

65 Kusht., neni 7.1.

66 Kusht., neni 45.3.

67 Kusht., nenet 24, 31.1, 32, 46, 119.3, 119.7.

68 Kusht., neni 22; DUDNj, nenet 1 e 2; KEDNj, nenet 6 e 14, dhe Prot. 12, neni 1.

zojnë interpretimin e Kushtetutës,⁶⁹ dhe ligji vendor kundër diskriminimit (i mbështetur në direktivat e Bashkimit Evropian).⁷⁰

51. Një mendim kyç i GjEDNj-së thotë se Konventa e ndalon trajtimin e pabarabartë në gëzimin e të drejtave për shkak të një karakteristike vetjake.⁷¹ Shteti shkel Konventën kur pa «justifikim objektiv e të arsyeshëm» — pra, pa qëllim të përligjshëm ose në shpërpjesëtim me qëllimin — e veçon një njeri nga tjetri në rrethana të ngjashme.⁷²

E drejta e pronës

52. Kushtetuta mbron të drejtën e pronës,⁷³ andaj shpronësimi lejohet vetëm nëse «është i autorizuar me ligj».⁷⁴ Tutje, Konventa Evropiane përcakton: «Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij, përveçse [...] në kushtet e parashikuara me ligj».⁷⁵ Përfundimisht, një e drejtë themelore e përcaktuar në kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet «vetëm me ligj».⁷⁶
53. Vendimet e GjEDNj-së, që sipas nenit 53 të Kushtetutës udhëzojnë interpretimin e të drejtave themelore, thonë se tatimi ose detyrimi në të holla që përcakton shteti përbën shpronësim. Jurisprudenca e Strasburgut u jep një kuptim të gjerë të koncepteve të *pronës* dhe *posedimit*. Prona dhe posedimi përfshijnë çfarëdo të drejte sendore, të luajtshme apo të paluajtshme. Tatimi «e privon personin në fjalë nga një posedim, d.m.th. nga sasia e parave që duhet paguar».⁷⁷ Rrjedhimisht, çdo

69 Kusht., neni 53; shih, p.sh., *G.N. k. Italisë*, GjEDNj 43134/05, Aktgjykim, 1.12.2009.

70 Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, 05/L-021, nenet 1–4; shih dhe LPPA, 05/L-031, neni 6.

71 Frëngjisht: «*une caractéristique personnelle (“situation”)*». *G.N. k. Italisë*, 43134/05, sipër, §116 (citon rastet *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen k. Danimarkës*, 7.12.1976, §56, séria A, no. 23; *Jones k. Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), 42639/04, 13.9.2005).

72 Frëngjisht: «*justification objective et raisonnable*». Po aty, §117 (citon rastet *Rasmussen k. Danimarkës*, 28.11.1984, § 38, séria A, no. 87; *Burden k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 13378/05, 29.4.2008, § 60; *D.H. k. Çekisë* [DhM], 57325/00, §175, CEDH 2007).

73 Kusht., neni 46.1.

74 Kusht., neni 46.3.

75 KEDNj, prot. 1, neni 1 (theksim i shtuar); shih dhe Kusht., neni 22.

76 Kusht., neni 55.1.

77 *Burden k. Britanisë*, GjEDNj, 13378/05, Aktgjykim, 29.4.2008, para. 59.

rast kur shteti detyron individin të paguajë të holla konsiderohet kufizim i së drejtës së pronës. Dhe kufizimi nuk lejohet pos me ligj.⁷⁸

Shkeljet e ZRrE-së

54. ZRrE ka cenuar të drejtat e parimet e sipërcekura duke futur tinëzisht në rend të ditës çështjen e tarifave nxitëse, të cilat favorizojnë haptazi ndërmarrje private të paracaktuara në kurriz të konsumatorëve që paguajnë tarifat.
55. Vendimi i ZRrE-së nuk ka bazë ligjore, duke cenuar kështu parimin e sundimit të ligjit, që përbën themelin e rendit kushtetues në Republikën e Kosovës. Asnjë nga ligjet mbi të cilat vepron ZRrE nuk e autorizon atë të vendosë tarifa nxitëse ose të subvencionojë veprimtarinë e operatorëve ekonomikë; ZRrE duhet të caktojë tarifat sipas instrumenteve të tregut.⁷⁹
56. Për më tepër, vendimi përmend si bazë një udhëzim administrativ të nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin. Ligji për energjinë parasheh cakun 25 për qind për BRE, kurse udhëzimi administrativ e ngre atë në 29.⁸⁰ Veç kësaj, udhëzimi administrativ është lëshuar nga ministri i një qeverie në dorëheqje, pa mandat demokratik dhe jashtë autorizimeve të saj kushtetuese.
57. Përfundimisht, ZRrE ua cenon qytetarëve të drejtën e pronës, duke i shpronësuar ata pa autorizim ligjor dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane.
58. Kështu vendimi i ZRrE-së bie ndesh me Kushtetutën dhe konventat ndërkombëtare, andaj duhet të anulohet.

78 Shih dhe rasti 265/2017, Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, para. 47–51.

79 Shih para. 62–72 të kësaj padie.

80 Po aty, para. 62–65.

B. Detyrimet ndërkombëtare dhe e drejta materiale

Baza juridike për ndihmën shtetërore dhe sektorin e energjisë

59. Në dispozitat mbi rendin ekonomik, Kushtetuta e Kosovës parasheh mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të konsumatorit.⁸¹ Tutje, përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në Kuvend zbatohen drejtpërsëdrejti dhe kanë epërsi ndaj të gjitha akteve vendore pas Kushtetutës.⁸²
60. Titulli VI i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim me BE-në (MSA), ratifikuar më 2015,⁸³ prek çështje ekonomike, ku përfshihen konkurrenca e lirë dhe ndalimi i ndihmës shtetërore,⁸⁴ mbrojtja e konsumatorit⁸⁵ dhe energjia.⁸⁶ Në veçanti, neni 114 i MSA-së rithekson detyrimet e Kosovës ndaj Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe për zbatimin e legjislacionit të BE-së për energjinë.
61. Duke u mbështetur në MSA, TKE dhe legjislacionin e BE-së, Kosova tashmë ka miratuar një sërë ligjesh relevante: Ligji për ndihmën shtetërore,⁸⁷ Ligji për mbrojtjen e konkurrencës,⁸⁸ Ligji për mbrojtjen e konsumatorit,⁸⁹ Ligji për energjinë,⁹⁰ dhe Ligji për rregullatorin e energjisë.⁹¹

Tarifat nxitëse nuk kanë bazë ligjore

62. Një akt administrativ është i paligjshëm kur tejkalon diskrecionin e ligjshëm të organit.⁹² Ndonëse Ligji për rregullatorin ngarkon ZRrE-në me detyrën për të caktuar tarifatat e energjisë elektrike dhe jep parime

81 Kusht., neni 119, para. 3 dhe 7.

82 Kusht., neni 19.

83 Ligji për ratifikimin e MSA-së, 05/L-069.

84 MSA, bashkëngjitur ligjit 05/L-069, neni 75; shih veçanërisht nenin 75.1(c).

85 Po aty, neni 81.

86 Po aty, neni 114.

87 **LNSh**, 05/L-100, neni 1.2.

88 03/L-229, ndrysh. me ligjin 04/L-226, neni 66.

89 06/L-034, neni 1.2.

90 LE, 05/L-081, neni 1.2.

91 LRrE, 05/L-084, neni 1.2.

92 LPPA, 05/L-031, neni 52.1.

dhe rregulla të caktimit të tyre, asnjë dispozitë ligjore nuk i jep ZRrE-së tagrin për të dizajnuar subvencione për operatorët ekonomikë.

63. Përveç kësaj, vendimi i ZRrE-së përmend si bazë ligjore Udhëzimin administrativ të MZhE-së 05/2017, që ngre njëanshëm cakun për BRE nga 25 në 29 për qind. Por ky udhëzim administrativ, që nuk është detyrues për ZRrE-në, është vetë kundërkushtetues e i kundërligjshëm. Neni 15.1 i Ligjit për energjinë parasheh cakun 25 për qind, kurse Udhëzimi administrativ — si akt nënligjor, që një ministri mund ta nxjerrë vetëm brenda autorizimeve që jep legjislacioni i miratuar në Kuvend — është në kundërshtim me Ligjin për energjinë.
64. Vërtet ka qenë ministria ajo që më 2013 ka nxjerrë një udhëzim administrativ për cakun e BRE-ve,⁹³ duke bartur kështu një detyrim ndërkombëtar në legjislacion vendor. Por nga viti 2016, caku është sanksionuar me ligj, andaj ngritja e caktut në 29 për qind është kundërkushtetuese dhe e kundërligjshme.
65. Rrjedhimisht, skema mbështetëse dhe tarifat nxitëse për BRE nuk kanë bazë ligjore, kështu që vendimi i 27 nëntorit 2019, që cakton tarifa të tilla, është i paligjshëm. Gjykata duhet ta anulojë këtë vendim, i cili prek drejtpërdrejt rendin kushtetues të Kosovës.

Rregullat e BE-së ndalojnë subvencionet pas vitit 2020 dhe pa konkurrencë të lirë

66. Normat e BE-së në parim ndalojnë ndihmën shtetërore, duke përfshirë skemat mbështetëse ose tarifat nxitëse për BRE. Komisioni Evropian, si organ i BE-së, tashmë ka vlerësuar se skemat mbështetëse për BRE përbëjnë ndihmë shtetërore, por se mund të autorizohen nën kushte të caktuara.⁹⁴
67. Për t'i ndihmuar shtetet në dizajnimin e skemave mbështetëse të ligjshme, ndërkaq, KE ka nxjerrë Udhëzimet për ndihmën shtetërore në mbrojtjen mjedisore dhe energji 2014–2020, ku thuhet:

93 UA-MZhe 01/2013.

94 P.sh., Vendim i Komision Evropian mbi ndihmën shtetërore, rastet NN 162/A/2003 dhe N 317/A/2006 për tarifat nxitëse të Austrisë, 4.7.2006; shih dhe LNSh, 05/L-100, neni 6.

Instrumentet e tregut, siç janë ankandet ose ecuritë e ofertimeve garuese, të hapura për të gjithë përftuesit që prodhojnë elektricitet nga burime të ripërtëritshme të energjisë dhe konkurrojnë në bazë të barabartë [...], duhet të sigurojnë normalisht që subvencionet të zvogëlohen në minimum me synim të heqjes së tyre në tërësi.⁹⁵

68. Pra, skemat mbështetëse duhet dizajnuar në atë mënyrë që mundëson zvogëlimin dhe mënjanimin e plotë të ndihmës deri në vitin 2020.⁹⁶
69. Edhe raporti për Kosovën i Komisionit Evropian ka bërë thirrje që mbështetja për energjinë e ripërtëritshme të jepet përmes ankandëve.⁹⁷
70. Vendimi i ZRrE-së nuk përfill udhëzimet e BE-së për të shfrytëzuar mjetet e tregut të lirë, por cakton vetë tarifat mbi çmimin e tregut. Ç'është më e keqja, ZRrE miraton tarifatat që do të jepen për 12 vjet në lartësi fikse, ndërkohë që nga viti 2020 duhet të mënjanojë subvencionet. Prandaj, vendimi i ZRrE-së shkel detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, në veçanti nenin 114 të MSA-së, si normë drejtpërdrejt e zbatueshme, dhe duhet të anulohet.

Tarifat e larta pa konkurrencë të lirë shkelin ligjin vendor

71. Ligji për rregullatorin e energjisë kërkon që e paditura të caktojë tarifa të arsyeshme për energjinë⁹⁸ si dhe të mbrojnë tregun e lirë dhe konsumatorët.⁹⁹ Në rastin tonë, ZRrE ka caktuar tarifa fikse shumë më të larta se çmimi i tregut, nuk ka shfrytëzuar instrumentet e tregut të lirë dhe ka vendosur t'ua ngarkojë mbi 16 milionë euro konsumatorëve.
72. Prandaj, vendimi është në kundërshtim me Ligjin për rregullatorin e energjisë, por dhe dispozitat e ndërlidhura kushtetuese e ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe konsumatorit.

95 Udhëzimet 2014–2020, para. 109 («*Market instruments, such as auctioning or competitive bidding process open to all generators producing electricity from renewable energy sources competing on equal footing at EEA level, should normally ensure that subsidies are reduced to a minimum in view of their complete phasing out*»).

96 Po aty, para. 108.

97 Raporti i 2019-tës Komisionit Evropian për Kosovën, *EC Kosovo 2019 Report*, SWD(2019) 216, § 3.2, f. 49; § 6.22, f. 82–83.

98 LRrE, 05/L-084, neni 15.1.5.

99 Po aty, neni 15.1.17.

Ndihma e dhënë pa autorizimin e Komisionit është e kundërligjshme

73. Çdo ndihmë shtetërore është e ndaluar, përveç nëse lejohet ose autorizohet sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për ndihmën shtetërore.¹⁰⁰ Njëherësh, quhet e kundërligjshme çdo ndihmë që jepet «pa njoftimin dhe autorizimin e Komisionit».¹⁰¹ Komisioni i Ndhmës Shtetërore është organ i pavarur i shtetit.¹⁰²
74. Ligji kosovar për ndihmën shtetërore rrjedh nga normat e BE-së.¹⁰³ Këto norma cilësojnë skemat mbështetëse për BRE si ndihmë shtetërore, por që mund të autorizohen nën kushte të caktuara.¹⁰⁴ Në rastin e Austrisë madje, Komisioni Evropian ka shprehur keqardhje që Austria ka zbatuar skemën pa njoftim paraprak.¹⁰⁵ Në rastin tonë, ZRrE nuk ka komunikuar me Komisionin e Ndhmës Shtetërore rreth skemës kosovare për BRE.
75. Pra, skema mbështetëse, me gjithë tarifatat nxitëse të caktuara me vendimin e ZRrE-së, është e kundërligjshme. Gjykata duhet ta anulojë këtë vendim.

C. Rregullat dhe parimet e procedurës***Vendimi është i paligjshëm sepse i mungon arsyetimi***

76. Sipas rregullave të procedurës, organi administrativ duhet të arsyetojë me shkrim vendimin që merr.¹⁰⁶
77. Ligji për procedurën e përgjithshme administrative përcakton se akti është i paligjshëm nëse i mungojnë elementet formale që kërkon ligji.¹⁰⁷ Ndër elementet formale të një akti administrativ përfshihet «arsyetimi për vendimin e marrë në dispozitiv».¹⁰⁸
78. Për më tepër, arsyetimi duhet të përfshijë:

100 LNSh, 05/L-100, nenet 4 e 6.

101 Po aty, neni 1.1.6.

102 Po aty, neni 9.1.

103 Po aty, neni 1.2.

104 P.sh., vendimi për tarifatat nxitëse të Austrisë, cituar në fusnotën 18.

105 Po aty, para. 61.

106 LPPA, 05/L-031, neni 48.1.

107 Po aty, neni 52.1.

108 Po aty, neni 47(3).

- « 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;
 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;
 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;
 1.5. *shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;*
 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. »¹⁰⁹

79. Edhe Ligji për rregullatorin e energjisë përcakton se vendimet e ZRrE-së duhet të përmbajnë arsyetimin.¹¹⁰ Në të kundërtën, akti konsiderohet i paligjshëm.
80. Në rastin tonë, ZRrE nuk ka dhënë kurrfarë arsyetimi për vendimin e marrë në dispozitiv. As ka përfshirë në vendim ndonjërin nga elementet e arsyetimit. Veçanërisht, nuk shpjeguar pse ka shpërfillur komentet e palëve të interesuara, të cilat dëshmojnë qartë se e vetmja mënyrë e ligjshme për të mbështetur prodhuesit e energjisë është përmes instrumenteve të tregut. Prandaj, sipas Ligjit të procedurës së përgjithshme administrative dhe Ligjit për rregullatorin e energjisë, vendimi është i paligjshëm, dhe Gjykata duhet ta anulojë atë.

Bordi i ZRrE-së ka nxjerrë vendimin jashtë rendit të ditës

81. Sipas Ligjit për rregullatorin e energjisë, kryesuesi i Bordit të ZRrE-së kumton rendin e ditës të paktën pesë ditë para mbledhjes së Bordit.¹¹¹
82. Vendimi për tarifatat nxitëse nuk është përfshirë në rendin e ditës që është dërguar para mbledhjes së 27 nëntorit 2019. Tek pasi ka filluar mbledhja, Boardi ka ndryshuar jashtëligjshëm rendin e ditës për të lejuar shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për tarifatat.
83. Për më tepër, mbledhja është mbajtur në një ditë zie kombëtare për viktimat e tërmetit shkatërrues të Durrësit. Asokohe, vëmendja e publikut ka qenë e përqendruar në përpjekjet të shpëtimit dhe ndihmës për

109 Po aty, neni 48.1 (theksimi i shtuar).

110 LRRrE, 05/L-084, neni 25.9.

111 Po aty, neni 25.3.

të prekurit nga fatkeqësia natyrore. Kurse të nesërmen, në Ditën e Flamurit, institucionet dhe organizatat e interesit publik nuk kanë punuar.

84. Çështja është shqyrtuar dhe është refuzuar në mbledhjen IX e Bordit, ndërsa rendi i ditës i paralajmëruar për mbledhjen X nuk e ka përmendur atë. Në këto rrethana, çdo person i arsyeshëm i interesuar për çështjen mund të kishte besuar se ajo nuk përbën më objekt shqyrtimi për Bordin e ZRrE-së, dhe kështu të dështonte të njoftohej për vendimet e marra. Me fjalë të tjera, Bordi ka vepruar në mënyrë që fsheh punën e tij dhe vë në lajthitje palët e prekura.
85. Për këto arsye, vendimi tinëzar i ZRrE-së është i paligjshëm, sepse është nxjerrë në kundërshtim me rregullat e procedurës së paraparë me ligj.

Vendimi favorizon biznese të caktuara, duke shkelur barazinë para ligjit dhe parime të tjera të procedurës

86. Ligjet për procedurën administrative dhe administratën shtetërore detyrojnë organet të veprojnë sipas parimeve të ligjshmërisë,¹¹² barazisë e paanshmërisë,¹¹³ profesionalizimit,¹¹⁴ transparencës,¹¹⁵ dhe mbrojtjes së interesit publik.¹¹⁶
87. Në rastin tonë, vendimi nuk është ligjshëm sepse nuk ka bazë ligjore që autorizon ZRrE-në të dizajnojë skema mbështetëse ose t'u mveshë konsumatorëve tarifa nxitëse.¹¹⁷
88. Vendimi shkel parimin e barazisë e të paanshmërisë, sepse favorizon operatorë privatë tashmë të ditur. Kështu u garanton për 12 vjet blerjen e energjisë një liste të kompanive që dihet saktë se kush janë dhe që gjashtëm kanë të njëjtin pronar. Shumica e kompanive përfituese kanë të njëjtën adresë.

112 LPPA, 05/L-031, neni 4; LASH, 06/L-113, neni 3.

113 LPPA, 05/L-031, nenet 6 e 7.

114 LASH, 06/L-113, neni 4.

115 LPPA, 05/L-031, neni 9, LASH, 06/L-113, neni 58.

116 LPPA, 05/L-031, neni 4.4; LASH, 06/L-113, neni 4.

117 Shih para. 76–80 të kësaj padie.

89. Tutje, ZRrE ka vepruar në shpërputhje me parimin e profesionalizmit, duke mos marrë parasysh rekomandimet e stafit të vet profesionist kundër tarifave nxitëse dhe në mbështetje të tregut të lirë.
90. ZRrE nuk ka qenë aspak transparente kur pa paralajmërim ka shqyrtuar dhe marrë vendimin për tarifën nxitëse. Vendimi që shqyrtuar dhe refuzuar në mbledhjen paraprake.
91. Në fund, ZRrE ka shkelur interesin publik për energji me çmim të përballueshëm dhe për shfrytëzimin e instrumenteve të tregut që nxisin konkurrencën dhe zhvillimin e sektorit në fjalë. Ekspertët çmojnë se tarifën nxitëse përfundimisht pengojnë investimet në tregun e BRE-ve.
92. Për këto arsye, vendimi i ZRrE-së shkel rëndë rregullat dhe parimet e procedurës, andaj Gjykata duhet ta anulojë.

VI. KËRKESË PËR SHTYRJE TË EKZEKUTIMIT

93. Paditësi në konflikt administrativ mund t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës që «ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar».¹¹⁸ Vendimi për shtyrje merret brenda tri ditësh.¹¹⁹
94. Paditësi Kurteshi i kërkon Gjykatës së nderuar që ta urdhërojë shtyrjen apo pezullimin e përmbarimit të vendimit të ZRrE-së.
95. Së pari, dëmi që do të pësonte paditësi nga zbatimi i tarifave nxitëse nuk mund të riparohet. Gjasat janë që, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përfituesit e skemës mbështetëse të kenë konsumuar subvencionet në formë të tarifave nxitëse dhe që këto t'u jenë faturuar konsumatorëve përfundimtarë, duke përfshirë paditësin. Shuma minimale që do të paguhet është 16,46 milionë euro.¹²⁰
96. Së dyti, shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, meqë tashmë ka dhe mund të zbatohen mekanizma të tjerë për të nxitur përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Madje, tarifat fikse shkurajojnë shfrytëzimin e tyre.
97. Vendimi i ZRrE-së është vetë në kundërshtim me rendin publik, të përcaktuar me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Andaj, efekti juridik që mund të prodhojë vendimi — në cenim të rendit publik të Republikës së Kosovës — kurrsesi nuk e justifikon interesin e mundshëm të një pale të tretë.
98. Së fundi, shtyrja e ekzekutimit nuk do të dëmtonte palët e interesuara, meqë efekti i vendimit do të zgjaste për një periudhë të caktuar, pa marrë parasysh datën e fillimit. Për më tepër, palët e interesuara kanë paraqitur qysh moti gatishmërinë e tyre për të prodhuar energji nga

118 LKA, 03/L-202, neni 22, para. 2 dhe 6.

119 Po aty, neni 22.7.

120 Shtojca (4): Ndikimi i tarifave nxitëse [...].

BRE. Ato formalisht nuk janë palë në procedurën administrative, sepse nuk kanë kërkuar marrjen e vendimit të kontestuar, dhe nuk kanë pasur kurrfarë pritshmërie të arsyeshme se do të përfitojnë nga nxjerrja e këtij vendimi.

99. Prandaj, mbështetur në nenin 22 të Ligjit për konfliktet administrative, paditësi i kërkon Gjykatës të nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. **Miratohet** si e themeltë kërkesa e paditësit Sami Kurteshi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V_1204_2019 të së paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.
- II. **Detyrohet** e paditura të shtyjë ekzekutimin e vendimit V_1204_2019 deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij konflikti administrativ.

VII. KËRKESËPADI

100. Mbështetur në provat e administruara dhe në argumentet e paraqitura në këtë padi, dhe duke u thirrur në Ligjin për konfliktet administrative, neni 46, paragrafët 1 e 2, paditësi i kërkon Gjykatës së nderuar të nxjerrë këtë:

AKTGJYKIM

- I. **Miratohet** në tërësi si e themeltë padia dhe kërkesëpadia e paditësit Sami Kurteshi ndaj të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës.
- II. **Anulohet** si kundërkushtues dhe i kundërligjshëm Vendimi V_1204_2019, i 27 nëntorit 2019, i të paditurës.
- III. **Detyrohet** e paditura t'i paguajë paditësit brenda 15 ditëve shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet që rrjedhin nga ky kontest gjyqësor.

Përfaqësuesi i paditësve:

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com